


AN EU FUNDED PROJECT MANAGED BY THE EUROPEAN UNION OFFICE IN KOSOVO

IMPLEMENTED BY



# RAPORTI PËR VLERËSIMIN E MANGËSIVE NË KOMPETENCA PËR GRATË FILLESTARE NË VERI DHE JUG TË MITROVICËS

MARS 2015



## **Tabela e përmbajtjes**

1. Hyrje	2
1.1 Definimi i Terminologjisë	2
1.2 Metodologjia	3
2. Mjedisi i Biznesit	3
2.1 Politikat mbi Aktivitetet e Biznesit dhe Aktivitetet Ekonomike	3
2.2 Perspektiva e Mitrovicës Jugore dhe Veriore	5
2.3 Instrumentet Mbështetëse për zhvillim ekonomik dhe të biznesit	6
3. Vlerësimi i Kompetencave Thelbësore	6
4. Gjetjet dhe Hartëzimi i Kompetencave	8
5. Rekomandimet	8

## 1. Hyrje

Ky raport, i porositur nga Community Building Mitrovica (CBM), ofron një vlerësim të mangësive të kompetencave të grave fillestare në biznes në Veri dhe Jug të Mitrovicës. Vlerësimi u përqendrua në identifikimin e boshllëqeve ndërmjet kapaciteteve të përgjithshme të grave fillestare, aftësitë dhe njohuritë që janë të nevojshme për menaxhimin e suksesshëm të biznesit. Përveç kësaj, janë marrë parasysh kushtet e tregut dhe instrumentet mbështetëse për zhvillimin e NVM-ve në vend.

Community Building Mitrovica (CBM) është një organizatë lokale jo-qeveritare (OJQ) që vepron në fushën e ndërtimit të paqes dhe komunitetit në rajonin më të gjerë të Mitrovicës në veri të Kosovës. Qëllimi i përgjithshëm i CBM-it është të lehtësojë kontaktin dhe dialogun në mes të qytetarëve dhe gjithë komunës së Mitrovicës. Projekti “*Mjedisi mbështetës për gratë fillestare në biznes në Veri dhe Jug të Mitrovicës*” ka për qëllim të mbështes sipërmarrësinë në mesin e grave që vijnë nga të gjitha bashkësitë etnike që jetojnë në Mitrovicën e Veriut dhe Jugut. Projekti financohet nga Zyra e BE-së në Kosovë dhe i bashkë-financuar nga Komuna e Mitrovicës dhe Fondacioni MOTT.

### 1.1 Definimi i Terminologjisë

Kompetenca është një term që është bërë tërheqëse që nga fillim vitet 1960. Kuptimi më i zakonshëm i kompetencave<sup>1</sup> është “kombinimi i njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve të cilat janë të nevojshme për të punësuarit në punët apo detyrat e tyre”. Edhe pse në fazat e saj të hershme, kompetenca është përdorur si motivim i performancës, sot ajo është parë si një seri e përrjetshme e të bërit dhe reflektuarit. Në të vërtetë, zhvillimi i kompetencave është bërë një koncept thelbësor i menaxhimit, veçanërisht në zhvillimin e ndërmarrësisë.

Kompetenca<sup>2</sup> është me rëndësi thelbësore për çdo kompani/institucion dhe individ për t'u marr me tregje të reja dhe kërkesave të reja nga myshterintë dhe klientët. Është e rëndësishme që të ketë një kuptim për faktin se dija individuale e çdo punëtori dhe një ditori e përbashkët për të gjithë kompaninë janë të një rëndësie të madhe për të arritur qëllimet strategjike dhe për të kryer planet e biznesit.

Rritja e konkurrencës në mes të individëve dhe kompanive/institucioneve udhëheq në kërkesa për cilësi më të lartë, kohë më të shkurtër e ofrimit dhe garanci më të mirë për shpërndarjen me kohë. Të gjitha këto kërkesa supozojnë se të gjithë punëtorët (ata të cilët kanë më shumë sesa vetëm pronarin) të kenë njohuri më të mirë dhe një kuptim më të mirë të aktiviteteve të kompanisë..

Në rastin e Mitrovicës (edhe në Jug edhe në Veri) dhe për shkak të numrit të madh të donatorëve, shumica e aktiviteteve kohët e fundit janë përqendruar në drejtim të zhvillimit ekonomik dhe mbështetjen e sektorit privat. Kjo mbështetje përfshin punën me një gamë të gjerë të individëve, kompanive ekzistuese (të regjistruara) dhe kompanive ekzistuese (të paregjistruara); ky mjedis i pasigurt është një sfidë e madhe dhe kërkon një proces të kujdesshëm dhe të rreptë për përzgjedhjen e kompetencave të rëndësishme për zhvillimin e biznesit.

Përcaktimi se cilat kompetenca janë çelësi për sukses është po aq e rëndësishme për metodologjinë e zbatimit që do të përdoret nga CBM në fazat e ardhshme të projektit.

Kompetenca nuk është vetëm një çështje e rëndësishme të kompanitë prodhuese që prodhojnë një produkt, por edhe të institucionet e ofrimit të shërbimeve, private dhe publike. Një zyrë e sigurimeve shoqërore, ose një zyrë punësimi prodhon shërbime për publikun që duhet të dorëzohen me kohë dhe me cilësi të mirë. Ky është një dallim shumë i rëndësishëm për shkak të faktit se shumica e kandidatëve të intervistuar vinin nga institucione të ndryshme ose tashmë punonin atje dhe planifikonin të fillojnë një biznes të ri, ose tashmë kanë një të tillë operativ. Kjo njohuri duhet të konsiderohet në çdo rast. Jo vetëm nga vetë kompanitë, por edhe nga sindikatat e punëtorëve dhe federatat e punëdhënësve bashkëpunojnë për një kuptim më të mirë të çështjes.

<sup>1</sup>Gibb, A. (1990). Trajnimi i trajnerëve të biznesit të vogël. *Gazeta e Trajnimit Industrial Evropian*14, 17-25.

<sup>2</sup>Fjala “Kompetencë” dhe fjala “njohuri” do të përdoret në mënyrë të këmbyeshme në këtë raport.

## 1.2 Metodologjia

Ky vlerësim është kryer duke përdorur metodologjinë sasiore dhe cilësore. Fillimisht, vlerësuesi ka kryer hulumtime nga tavolina (zyra) për rishikimin e botimeve ekzistuese mbi kompetencën, gratë sipërmarrëse dhe mjedisit për mundësimin e të bërit biznes në Kosovë. Pas krijimit të bazës në formë të literaturës, vlerësuesi ka shqyrtuar dhe analizuar pyetësorët që janë përdorur gjatë intervistave me pjesëmarrësit në trajnime të projektit. Hulumtimi është bërë me pjesëmarrës individual, diskutime në grup dhe nëpërmjet analizës konkrete të rastit. Ky lloj i kërkimit krijoi bazë të fortë për rekomandime të mëtejshme dhe mundësi të mirë për të diskutuar drejtpërdrejt me kandidatët potencialë. Faza e fundit e vlerësimit ka përfshirë bashkimin e shqyrtimit nga tavolina me analizën e pyetësorit.

## 2. Mjedi i Biznesit

Edhe pse Kosova ka përparuar ndjeshëm gjatë dekadës së fundit, shumë nga sfidat vazhdojnë të bëjnë presion pothuajse të gjitha sferat e jetës. Cilësia gjinore në terma të përgjithshëm, mbetet një objektivi i paarritur. Gratë në Kosovë kanë qasje të pabarabartë në burimet sociale dhe ekonomike. Diskriminimi social dhe ligjor është ende i përhapur, sidomos kur bëhet fjalë për fuqizimin e grave në ekonomi dhe politikë. Në anën tjetër, Kosova ka një kornizë ligjore gjithëpërfshirëse në drejtim të barazisë gjinore, fuqizimit dhe mos-diskriminimit në baza gjinore. Ligji për Barazi Gjinore, Programi i Kosovës për Barazi Gjinore dhe Ligji kundër diskriminimit përbëjnë kornizën për përfshirje gjinore. Agjencia për Barazi Gjinore është një mekanizëm shtesë që kërkon të garantoj sjelljen, pozitën, mundësinë dhe përfitime të barabarta për të dyja gjinitë në të gjitha sferat e jetës. Edhe pse korniza përcakton terrenin për barazi gjinore, diskriminimi ende vazhdon për shkak të mungesës së respektimit të dispozitave.

### 2.1 Politikat mbi Aktivitetet e Biznesit dhe Aktivitetet Ekonomike

Pjesëmarrja e grave në punë të biznesit dhe ekonomike është ende e kufizuar në Kosovë. Pozicioni i tyre i marginalizuar kufizon qasjen në informata dhe burime. Për më tepër, mungesa e pronësisë, burimeve financiare dhe mbështetjes institucionale pengon fuqizimin e tyre ekonomik. Kjo është ndihmuar edhe më tej nga mungesa e politikave të qëndrueshme të barabarta gjinore, që do të forconte e pjesëmarrjen e grave në aktivitete sipërmarrëse.

Ekonomia formale në Kosovë ka një pjesëmarrje më të madhe nga burrat se sa gratë. Shkalla e punësimit të grave është rreth 18%, më e ulëta në Evropë, ndërkohë që rreth 55% e meshkujve janë të punësuar. Gratë kanë tendencë më të madhe të punojnë në sektorët që më së pak paguhen, siç janë shëndetësia dhe arsimi (rreth 40% të të gjitha grave në tregun e punës), ndërsa burrat punojnë në fushën e energjisë dhe të ndërtimit, të cilat paguhen më mirë. Burimet e ndryshme sugjerojnë se gratë zotërojnë 5-11% të bizneseve në Kosovë. Për më tepër, 99.9% e bizneseve që gratë zotërojnë janë mikro-ndërmarrje të përbëra nga 1-9 të punësuar; gratë kanë mesatarisht 3.07 të punësuar, në krahasim me 5.27 në mesin e bizneseve të drejtuara nga burrat. Gratë nuk kanë qasje në kredi dhe huamarrje siç bëjnë burrat, sepse ato nuk kanë kolateral, histori të kredisë, dhe lidhje. Kështu, meshkujt mbajnë rreth 92% të pronave kolaterale në Kosovë. Vetëm 3% e kredive të bankave komerciale shkojnë për gratë. Gratë gjithashtu kanë përqindjen më të lartë të kredive të refuzuara.

Përshkrimi Statistikorë	Meshkuj	Femra
Regjistrimi fillestar bruto	95%	96%
Regjistrimi i mesëm bruto	96%	88%
Braktisja e shkollës mesme	71%	29%
Regjistrimi terciar bruto	55%	45%
Shkalla e pjesëmarrjes së forcës së punës 2012	55%	17.8%
Shkalla e pjesëmarrjes së forcës së punës 2009	68%	29%
Papunësia	28%	40%
Papunësia te të rinjtë	52%	63.8%
Pronarët e biznesit	91.8%	8.2%
Llogaritë në institucione formale financiare	57%	31%

Burimi: Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, 2014

Gratë e biznesit kanë identifikuar sfidat e tyre kryesore, si: mungesa e qasjes në financim, rregulloret e pamjaftueshme tatimore, praktikat bankare të këqija, diskriminimi nga klientët, si dhe klimën e përgjithshme të dobët investuese në Kosovë. Megjithatë, taksat në Kosovë janë shumë të ulëta në krahasim me vende të tjera në Evropë; TVSH-ja është 18%, dhe tatimi mbi të ardhurat shkon deri në 10%. Ekstremizmi fetar ndikon në ekonominë formale me fonde, si dhe traditat që nxisin rolin e grave brenda familjes dhe me fëmijët, në vend se në tregun e punës.

Në Kosovë sektori joformal ka gjasa se përbën rreth 10% të ekonomisë<sup>3</sup>, dhe shumica e atyre që janë përfshirë sipas të gjitha gjasave janë gra. Pushimi i lehonisë sipas Ligjit të ri të Punës mund të kontribuojë për mbi-përfaqësim të gravenë punë joformale. Në vendet në zhvillim, rreth 80% e njerëzve që punojnë në sektorin joformal janë gra. Në Evropë vlerësohet se më shumë se gjysma e popullsisë në sektorin joformal janë gratë dhe ndoshta janë rreth 60-65%. Rreth 60% janë ata punëtorë me paga dhe rreth 40% janë të vetëpunësuar. Në Kosovë, shumë gra shesin produkte siç janë specat, ushqime të përpunuara, ose produkte artizanale. Gratë gjithashtu ofrojnë shërbime siç janë shërbime të brendshme, kujdesie, apo rregullim i flokëve. Burrat kanë tendencë të jenë të mbi-përfaqësuar në mesin e personave të përfshirë në ekonominë joformale të prodhimit dhe trafikimit të drogës, duke përbërë 96.4% të personave të arrestuar për përfshirje në këtë "biznes"<sup>4</sup>. Autoriteti tatimor ka luftuar ekonominë joformale dhe ka shtyrë shumë biznese të zyrtarizojnë atë; shumica e këtyre bizneseve kanë qenë të udhëhequra nga femrat. Sa i përket punës së fëmijëve, djemtë fillojnë të punojnë në një moshë më të re dhe punojnë më shumë orë se sa vajzat, por kanë më shumë gjasa të paguhen-kompensohen për punën e tyre.

Në vitin 2011, rreth 30% e njerëzve në Kosovë jetonin në varfëri dhe 10% në varfëri të skajshme; më të varfëritë jetojnë në fshat (65%). Pak më shumë gra jetojnë në varfëri (30.3% e femrave) sesa meshkujt (29.2%). Gratë krye-familjare duket se kanë një normë më të lartë të varfërisë se familjet të udhëhequra nga meshkujt (39.8 në krahasim me 29). Megjithatë, fëmijët e familjeve të grave kryefamiljare duket në mënyrë të konsiderueshme ka më pak të ngjarë të jetojnë në varfëri; këto familje kanë tendencë të mbështeten më shumë në paratë e dërguara nga jashtë Kosovës.

Aktualisht nuk ekziston plan për reduktimin e varfërisë në Kosovë, edhe pse shumica e vendeve të tjera në rajon kanë një të tillë. Banka Botërore thekson nevojën për veprime të koordinuara për avancimin e mundësive të barabarta për gratë në botën e punës, siç janë adresimi i paragjykimëve gjinore në fazën fillestare, duke zgjeruar qasjen e grave në pronë dhe financa, si dhe duke rritur moshënligjore të daljes në pension: këto mund të kenë ndikime të mëdha në luftimin e varfërisë. Globalizimi dhe liberalizimi i tregtisë rrit rrjedhën e mallrave dhe kapitalit në vende të ndryshme dhe gjithashtu kontribuon në rritjen ekonomike. Rritja e bujqësisë ka tendencë për të reduktuar varfërinë dhe për të përmirësuar sigurimin e ushqimit. Në të kundërtën, rritja e shpejtë që zgjeron pabarazinë e të ardhurave, e cila ka ndodhur gjatë dy dekadave të fundit, ka gjasa të dëmtojë të varfërit. Femrat janë të prekur në mënyrë disproporcionale nga zgjerimi i pabarazisë për shkak se ata kanë tendencë për të fituar paga më të ulëta dhe të kenë më pak arsimim, më pak aftësi dhe më pak lëvizshmëri se burrat.

Femrat përbëjnë 82.2% të personave joaktive në tregun e punës. Femrat kujdesen për fëmijët, të sëmurët apo të moshuarit (39.4%); janë në arsim apo trajnim (15.8%); ose nuk besojnë se puna është në dispozicion (14.6%). Personat me aftësi të kufizuara marrin ndihmë sociale të ulët dhe kanë pak qasje në tregun e punës. Kur është fjala për punë praktike, njerëzit me aftësi të kufizuara ndjehen se ata nuk janë përfshirë për shkak se punëdhënësit do të duhej të ndryshonin vendet e tyre të punës. Për të moshuarit pensioni bazë është i ulët, dhe në një masë, i krahasueshëm me asistencë sociale; personat e prekur nga lufta dhe heronjtë e luftës marrin shumë më tepër. Personat të cilët varen vetëm nga pensionet ka gjasa të jetojnë nën nivelin e varfërisë.

Nuk ekziston asnjë plan punësimi në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe përpiqet që të zbatojë mandatin e vet pasi që Ministria e Financave nuk e miraton buxhetin e kërkuar nga ata. Zhvillimi i infrastrukturës publike, përfshirë rrugët, hekurudhat, furnizimi me energji, si dhe shpërndarja e energjisë elektrike, kanë qenë aktivitetet kryesore qeveritare nga të cilat pritjet të ndikojnë pozitivisht në zhvillimin ekonomik dhe punësimin, kryesisht për

<sup>3</sup>Instituti Riinvest. *Të paguhet ose të mos paguhet: Një Perspektivë Biznesi të jo-formalitetit në Kosovë*. Prishtinë: Instituti Riinvest, 2013.

<sup>4</sup>Ministria e Punëve të Brendshme, Strategjia e Kosovës dhe Plani i Veprimit për Luftimin e Trafikimit.

meshkujt në sektorin e ndërtimit. G-7, një rrjet i grave të suksesshme në biznese, e krijoi Odën Ekonomike të Grave të Tregtisë.

Diaspora ofron disa investime në Kosovë, kryesisht në ndërtim, pasuri të patundshme, dhe bujqësi. Në dy të tretat e rasteve, remitancat kalojnë nga njëri te tjetri. Pak më shumë se 20% e familjeve pranojnë remitenca. Për shembull, zhvillimi i bujqësisë dhe rritja e kafshëve përgjatë lumit Ibër, pjesërisht financuar nga Diaspora, do të krijojë punë për gratë me rreth 4.500 të punësuar që janë planifikuar. Një fabrikë e kërpuhave industriale financuar nga Japonia do të punësojë 3.000 persona.

Nuk ekzistojnë shërbime të veçanta për integrimin e personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës. Papunësia është e rëndë për romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët. Ata do të donin të shihnin më shumë konkurse të punës që i mirëpresin ata për të aplikuar dhe programe të veçanta të praktikës për përvojën e punës.

Gratë kanë tendencë të ndërmarrin shumicën e përgjegjësisë familjare, duke përfshirë kujdesin për fëmijët, të moshuarit, dhe të tjerët me nevoja të veçanta, si dhe mirëmbajtjen e brendshme në shtëpi. Burrat kanë tendencë të punojnë jashtë shtëpisë. Gratë në grup-moshën 25-54 kalojnë 10-20% të kohës së tyre në punë jashtë shtëpisë, dhe 80% të kohës së tyre në punët e shtëpisë. Burrat kalojnë 50-80% të kohës së tyre në punë jashtë shtëpisë dhe rreth 10-15% në familje. Pasi që gratë kanë tendencë për të kryer më shumë punë në shtëpi, ato gjithashtu kanë tendencë të kenë më pak burime, pasi kjo punë e tyre nuk paguhet.

Plani Kombëtar i Zhvillimit që është miratuar së fundmi 2016-2021 i referohet fuqizimit të grave në dy instanca. Fokusi i parë është vendosur në rritjen e regjistrimit të vajzave në arsimin para fillor dhe fillor, me qëllim të ndikimit në përmirësimin e pozitës së tyre për të hyrë në tregun e punës. Fokusi i dytë është përmirësimi i të drejtave të pronësisë, duke nxitur gjithashtu të drejtën e pronësisë nga ana e grave. Kjo e drejtë ka pasur gjithashtu për qëllim të ndikoj edhe në qasjen në financa, pra të përmirësohen mundësitë për zhvillimin e sektorit privat për biznese në pronësi të grave.

## 2.2 Perspektiva e Mitrovicës Jugore dhe Veriore

**Komuna e Mitrovicës Jugore** është e vendosur në veri të Kosovës, në jug të lumit Ibër. Përfshin qytetin e Mitrovicës së Jugut dhe rreth 40 fshatra. Sipas regjistrimit të popullsisë dhe banesave në Kosovë në vitin 2011, popullsia e përgjithshme është 71,909. Pjesa më e madhe e popullsisë përbëhet nga Shqiptarët, si dhe grupeve minoritare të Ashkalive, Romëve, Turqve, Boshnjakëve dhe Goranëve.

Ekonomia e Mitrovicës së Jugut, kryesisht mbështetet në më shumë se 1000 ndërmarrje private dhe ndërmarrjes shoqërore Trepça - e cila operon me kapacitete teknologjike dhe njerëzore të kufizuara. Shumica e ndërmarrjeve private janë përqendruar në sektorët e tregtisë dhe të ofrimit të shërbimeve. Kohët e fundit, kanë filluar të rriten disa përpjekje të vogla të prodhimit dhe përpunimit të drurit dhe industrisë tekstile. Mbi 60% e të rinjve dhe grave janë të papunë; kjo është gjendja më e lartë e papunësisë në Kosovë dhe kjo në masë të madhe ndikon në gjendjen shoqërore dhe politike. Gratë dhe të rinjtë inkurajohen të jenë më aktiv në aktivitete sipërmarrëse dhe të themelojnë ndërmarrje private. Në këtë drejtim, statistikën e fundit tregojnë disa përmirësime pozitive në punësimin në bujqësi, e cila është stimuluar kryesisht nga Qeveria e Kosovës.

Shumica e të punësuarve në institucionet publike varen nga pagat e Qeverisë së Kosovës. Në këtë drejtim, pagat janë të ngjashme me shërbyesit e tjerë civil në Kosovë. Pagat mesatare në sektorin publik ndryshojnë nga rreth 250 € në sistemin arsimor (fillor dhe të mesëm) deri në 500€ + në nivelet më të larta të arsimit. Situata në sektorin privat është duke u përmirësuar nga viti në vit dhe pagat janë duke u përmirësuar dhe ndryshojnë nga 200€ (nivelet hyrës) në shërbime deri në 500€ + për punëtorët me përvojë në prodhimtari të vogël dhe shërbimeve të larta profesionale.

**Komuna e Mitrovicës Veriore** është e vendosur në veri të Kosovës. Përfshin qytetin e Mitrovicës Veriore dhe fshatrat përreth. Në Mitrovicën e Veriut ka rreth 29,460 banorë me shumicë Serbët, Shqiptarët me rreth 20%, si dhe Boshnjakët dhe Goranët.<sup>5</sup>

<sup>5</sup><http://www.osce.org/kosovo/122118?download=true> dhe <http://www.osce.org/kosovo/122119?download=true>

Ekonomia e Mitrovicës së Veriut, kryesisht mbështetet në ndërmarrjet publike, administratën lokale si dhe ndihmën nga Qeveria e Serbisë, institucionet e Kosovës dhe bashkësinë ndërkombëtare. Gjithashtu ka edhe mbi njëqind biznese të vogla të cilat kryesisht ofrojnë mallra dhe shërbime. Zhvillimet e fundit në lidhje me mbështetjen që do ti ofrohet zhvillimit të sektorit privat mund të ndryshojë lehtësisht këtë situatë. Të rinjtë duhet të inkurajohen të jenë më aktiv në aktivitetet sipërmarrëse dhe krijimin e ndërmarrjeve private.

Shumica e të punësuarve në institucionet publike janë në varësi të pagave edhe nga Qeveria e Kosovës edhe e Serbisë. Në këtë drejtim, pagat janë të ngjashme me shërbyesit e tjerë publikë në Serbi dhe Kosovë. Pagat mesatare në sektorin publik ndryshojnë nga rreth 350 € në sistemin arsimor (fillor dhe të mesëm) në 500€ + në nivelet më të larta të arsimit. Situata në sektorin privat nuk është aq e mirë si në sektorin publik; pagat ndryshojnë nga 150 € (nivelit fillestar) në shërbime deri në 450 € për punëtorët me përvojë në në prodhimtari të vogël dhe shërbimeve të larta profesionale.

### **2.3 Instrumentet Mbështetëse për zhvillim ekonomik dhe të biznesit**

Kosova ka përparuar mjaft me instrumente që parashikohen për zhvillimin e biznesit. Sektori financiar, i përbërë kryesisht nga bankat komerciale, është duke siguruar një numër të mekanizmave që mbështesin zhvillimin e sektorit privat. Përveç kësaj, qeveria ka krijuar disa programe që janë të bazuara në sektorë dhe të fokusuara në ofrimin e granteve dhe subvencioneve. Për më tepër, një numër më i ulët i donatorëve dhe organizatave ndërkombëtare janë ende duke ofruar grante për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Megjithatë, të gjitha këto instrumente janë të përgjithshme dhe në mënyrë specifike nuk kanë shënjestërbizneset e grave.

I vetmi instrument në dispozicion dhe i njohur që është zhvilluar me qëllim për bizneset e grave është Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) Gratë në Programin e Biznesit. Si pjesë e veprimtarisë së tij rajonale, BERZH ka dhënë një kredi prej 3 milion euro për TEB Bankën për të përmirësuar qasjen në financa për gratë e Kosovës, si dhe rritjen e kapaciteteve të tyre menaxhuese përmes asistencës teknike dhe shërbime këshilluese të biznesit.

Bankat komerciale kanë zhvilluar në mënyrë të qëndrueshme në Kosovën e pasluftës. Sot, ato konsiderohen si një nga ofruesit më të avancuar të financimit tregtar në Ballkan. Niveli i stabilitetit dhe likuiditetit është optimal dhe mospagimi është më i ulët në rajon. Edhe pse deri kohëve të fundit normat e interesit kanë qenë relativisht të larta, bankat komerciale janë bërë më pak kundërshtues nga rreziku. Tani, normat e interesit konsiderohet të jenë mjaft konkurruese dhe në përgjithësi mund të shërbejnë si një instrument i besueshëm për zhvillimin e sektorit privat. Përveç kësaj, bankat tregtare gjithashtu ofrojnë instrumente të tjera, dmth garanci, lizing, etj që janë përdorur shumë në ekonomitë e tregut.

Për vite me rradhë Qeveria e Kosovës ka filluar ofrimin e granteve dhe subvencioneve për bizneset në sektorin e bujqësisë. Grantet dhe subvencionet kanë dhënë rezultate pozitive sidomos për zhvillimin e ndërmarrësisë në bujqësi përpemë, perime, bagëti, etj. Numri i fermerëve, si dhe madhësia e tokës së punueshme dhe kopetëjanërritur me shpejtësi gjatë viteve të fundit.

Donatorët dhe organizatat ndërkombëtare vazhdojnë të japin disa grante dhe mundësi me ndarje të shpenzimeve për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Megjithatë, numri i organizatave që merren me këtë çështje është shumë më e ulët se më parë. Për më tepër, grantet në përgjithësi synojnë kompanitë që janë vendosur mirë dhe me perspektiva për rritje solide. Përveç kësaj, fokusi i tyre është edhe specifik ndaj sektorëve, siç janë përpunimi i drurit, tekstili, turizmiqë janë në ballë të ofrimit të granteve.

Dhe në fund, vitet e fundit kanë dhënë edhe dritë instrumenteve të tjera, siç janë kapitali aksionar dhe investime të kapitalit. Edhe pse kapitali aksionarka fituar rëndësi në sektorin e TIK, investimet e kapitalit, që ofrohet më pak nga Kosovarët dhe më shumë nga organizata të tilla si BERZH, përqendrohet në industrinë e tjera që kanë perspektivë të konsiderueshme për rritje.

Mund të konkludohet se instrumentet për zhvillimin e biznesit janë mjaft të ndryshme dhe më të fortë nga dita në ditë. Megjithatë, shumica e këtyre instrumenteve synojnë bizneset ekzistuese me përvojë; shumë prej instrumenteve në fakt përjashtojnë bizneset e reja. Nga



ana tjetër, duke pranuar se vetëm gratë kanë më pak qasje në financa, gratë fillestare në biznes do të kufizoheshin përdorimin e instrumenteve në të ardhmen e konsiderueshme në Kosovë. E vetmja zgjidhje do të ishte hartimi dhe zbatimii instrumenteve të synuara për gratë fillestare.

### 3. Vlerësimi i Kompetencave Thelbësore

Në bazë të planit fillestar për vlerësimin e kompetencave kryesore, një numër i madh i kompetencave janë konsideruar të vlerësohen. Por, pas hulumtimeve me mbi 70 gra pronare të biznesit, gratë që kanë planifikuar të fillojnë biznesin dhe të atyre që janë duke punuar në institucione dhe janë të gatshme për të hyrë në biznes, lista e kompetencave është shkurtuar. Për shkak të faktit se shumica e bizneseve të planifikuara janë të interesuar të veprojnë në masë të madhe në nivel lokal, që do të thotë në rajonin e Mitrovicës dhe vetëm pak janë të interesuar/tashmë punojnë në tërë Kosovën, këto kompetenca më tej humbinnë rëndësi dhe për këtë arsye janë vlerësuar në bazë të ndikimit të tyre.

Tabela e mëposhtme paraqet të gjitha kompetencat e analizuara që janë thelbësore për pronarët e bizneseve dhe personelinkuq në trajtimin e aktiviteteve të biznesit. Shtatë kompetencat kryesore u vlerësuan si dhe përkufizim dhe rëndësia e tyre për këtë vlerësim janë përshkruar më poshtë:

	Kompetenca	Përshkrimi
1	<b>Komunikimi</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përvoja Social - Pjesëmarrja në disa ndërveprime dhe aktivitete sociale;</li> <li>- Konfirmimi Social - i referohet njohjes së qëllimeve të partnerit (blerësit dhe furnizuesit);</li> <li>- Shpalosja e përshtatshme - duke qenë të ndjeshëm ndaj sasisë dhe llojit të informatës;</li> <li>- Artikulimi - aftësia për të shprehur idetë nëpërmjet gjuhës;</li> <li>- Humori - aftësia për të përdorur humorin në përshtatjen me situatat sociale;</li> </ul>
2	<b>Shkrimi i qartë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Aftësia për të shkruar çdo gjë që ata dinë në lidhje me biznesin e tyre;</li> <li>- Aftësia për të shprehur / prezantuar me shkrim SWOT-indhe konsumatorëte tyre;</li> <li>- Shkrimi qartë se çfarë dhe pse ata kanë nevojë për mbështetje;</li> </ul>
3	<b>Inovacioni</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Kreativiteti: a) Gjenerimi i Ideve, b) Të menduarit kritik, c) Sinteza/Riorganizimi dhe d) Zgjidhja Kreative e Problemit</li> <li>- Ndërmarrësia: a) Identifikimi i problemit, b) Kërkimi i përmirësimit, c) Mbledhja e informatave, d) Të menduarit e pavarur dhe e) Know-how teknologjike;</li> <li>- Perspektiva integrimi: a) Të hapurit ndaj ideve, b) Të orientuar nga hulumtimi c) Bashkëpunimi dhe e) Interesimi në çështjet jo-punuese</li> <li>- Parashikimi: a) Sistemet e perceptimit, b) Vlerësimi i pasojave afatgjatedhe c) visioni dhe</li> </ul>

4	<b>Mundësitë e tregut</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Menaxhimi i ndryshimit: a) Marrja e rrezikut në mënyrë inteligjente, b) Sfidimi i status quo, c) Ndjeshmëria për situatën dhe vendin</li> <li>- Të vetëdijshëm për blerësit ekzistues kryesor në rajon;</li> <li>- Njohja e kanaleve të shpërndarjes;</li> <li>- Informata në lidhje me madhësinë e tregut dhe pjesëmarrjen e saj në këtë treg;</li> <li>- Lista e konkurrentëve kryesorë dhe produkteve të tyre;</li> </ul>
5	<b>Vizioni Strategjik</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Optimist për të ardhmen dhe mundësitë;</li> <li>- Bisedimet përtej të sotshmes dhe roli i saj në ndikimin në të ardhmen;</li> <li>- Gjeneron ndjenjën e optimizmit në të tjerët dhe rekruton mbështetjen për të ardhmen;</li> </ul>
6	<b>Orientimi në Teknologji</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Bindë të tjerët për urgjencë për mbështetje;</li> <li>- Përdor zgjidhjet e fundit të IT për promovim;</li> <li>- E vetëdijshme për zgjidhje teknologjike në biznesin e saj;</li> <li>- Përdor ose planifikon të përdor Mediat Sociale për të bashkëvepruar me blerësit potencial dhe konsumatorët;</li> </ul>
7	<b>Zgjidhja Analitike e Problemit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Komunikon me email dhe rregullisht i'u përgjigjet emailave;</li> <li>- Aftësia për të zgjidhur problemet shpejt, por në mënyrë efektive;</li> <li>- Qasje hap-pas-hapi në të menduar që lejon zgjidhjen e problemeve komplekse;</li> <li>- Merr vendime që janë të ndjeshme dhe në bazë të informatave në dispozicion;</li> </ul>

#### 4. Gjetjet dhe Hartëzimi i Kompetencave

Bazuar në vlerësim dhe diskutime me 70 grave të intervistuar që janë të interesuara për të filluar një biznes të ri, ato që tashmë kanë një të tillë dhe ato që janë të interesuara për të regjistruar një biznes të përgjithshëm, gjetjet e përbashkëta janë paraqitur me ngjyra dhe më vonë janë shpjeguar në detaje për secilën kompetencë.

Fushat me ngjyrë të gjelbër janë kompetencat ekzistuese në mesin e grave të vlerësuara nga intervistat; ndërsa ato me ngjyrë të kuqe janë kompetencat të nevojshme për të minimizuar rrezikun e dështimit gjatë vitit të parë të biznesit - viti kritik për çdo fillim. Rezultatet përmbledhen dhe mesazhet merren parasysh.

Harta e kompetencave ekzistuese dhe që mungojnë:

Kompetenca	përshtatje e shkëlqyer	përshtatje e mirë	E pranueshme	Margjinale	përshtatje e dobët
Komunikimi					
Të shkruarit e qartë					
Inovacioni					
Mundësitë e tregut					
Vizioni Strategjik					
Orientimi në Teknologji					
Zgjidhja Analitike e Problemit					

## 5. Rekomandimet

Rekomandimet janë të bazuara në 1) strukturën ekonomike të Mitrovicës së Jugut dhe të Veriut, dhe 2) kompetencat kryesore të personave të intervistuar gjatë kësaj detyre. Ky vlerësim ka për qëllim të përmirësojë njohuritë ekzistuese për kompetencat dhe boshllëqet e njohurive të femrave që janë të interesuara për të filluar një biznes në Mitrovicë, të Veriut dhe të Jugut.

Në situatat kur informacioni bazë mungon, ose ekzistojnë të dhëna statistikore kontradiktore, ky vlerësim më shumë është i bazuar në intervista të drejtpërdrejta dhe diskutimet me përfaqësues të bizneseve të grave lokale. Kjo mundësi ka mundësuar autorin të gjeneroj disa rekomandime për krijimin e një strukture të qëndrueshme në mbështetjen e bizneseve të grave në Mitrovicë.

Bazuar në strukturën e bizneseve ekzistuese dhe grave që janë të interesuar për të filluar biznesin e vet (fillestare), sektorët në vijim janë më përkatëse:

- 1) Shërbimet,
- 2) Bujqësia,
- 3) Tregtia, dhe
- 4) Prodhimtaria e lehtë (prodhimtaria e ulët)

1) **Shërbimet** kryesisht janë në pronësi dhe menaxhohen nga gratë dhe këto lloje të biznesit janë gjithashtu të lehta për bizneset e reja, në rastet kur pronari i ri i biznesit ka përvojë ose sfond arsimor. Këto lloje të bizneseve nuk kërkojnë shuma të mëdha financiare për t'uthemeluar dhe kostot e operimit janë minimale.

Këto biznese janë të rekomanduara të mbështeten nga programi dhe shumica e aplikacioneve janë parashikuar të jenë nga ky grup i bizneseve. Për shkak të kufizimit të tokës bujqësore, si dhe përqendrimit të madh të studentëve në qytet, shkolla e mesme dhe universitet, në veçantë në Mitrovicën Veriore, ky grup i bizneseve pritet të dominojë.

***Nga ana tjetër, rekomandimi është që edhe përvoja në të kaluarën edhe ndarja e pjesës sëshpenzimeve me aplikuesin duhet të jetë një parakusht për mbështetjen e CBM-së, para se të analizohen kompetencat e kandidatit; përndryshe shumica e aplikantëve në këtë sektor mund lehtë "të marrin një rrezik" në qoftë se pjesa e tyre e kostove nuk është i rëndësishëm.***

2) **Bizneset Bujqësore** zakonisht janë ndërmarrje në pronësi të familjes që janë të menaxhuara në përgjithësi në kombinim me bashkëshortin dhe anëtarët e tjerë të familjes. Këto biznese në disa nën-sektorë të bujqësisë, siç janë) prodhimi i mjaltit, b) kultivimi serë i luleve, c) prodhimi i perimeve, c) prodhime tjera bujqësore dhe d) Fermat e vogla të pulave që nuk kërkojnë infrastrukturë solide dhe financiare, munden lehtësisht të jenë në pronësi dhe të menaxhohen nga gratë, ndërsa në disa nën-sektorë të bujqësisë si a) prodhimi i qumështit industrial, b) ferma e lopëve dhe c) prodhimi i misrit dhe e grurit, janë të vështira për t'u menaxhuar nga gratë dhe gjithashtu kërkon një pjesë të madhe të investimeve përgatitore dhe financave për t'uthemeluar. Për më tepër, mirëmbajtja e këtyre bizneseve është e komplikuar. Disa certifikata dhe kushte fito-sanitare janë gjithashtu kërkesa të vazhdueshme.

***Prandaj, rekomandimi është që sektori i bujqësisë duhet të mbështetet përfundimisht, por kufizuar në disa produkte bujqësore më të "lehta". Mbështetja duhet të fokusohet në ata aplikantë që përfshijnë më shumë anëtarë të familjes, kanë tokën e tyre dhe makina bujqësore, në mënyrë që të maksimizohet ndikimi i biznesit dhe të krijohet prodhim i qëndrueshëm. Kompetencat që këto candidate të biznesit duhet të kenë janë inovacioni dhe komunikimi, por ata duhet të jenë teknologjikisht të vetëdijshëm për të minimizuar kostot dhe për të rritur produktivitetin. Kandidatët nga ky sektor gjithmonë mund të krijojnë vende të reja pune dhe të rrisin bizneset në rajonin e Mitrovicës (më shumë në Jug).***

3) **Bizneset e tregtisë** janë më të lehta për t'uthemeluar për fillestar, por në të njëjtën kohë shumë të brishtanë dy-tre vitet e para të ekzistencës. Gjithashtu, zgjerimi i bizneseve ekzistuese janë zakonisht të lehta dhe kanë shumë pak nevojafinanciare.

**Rekomandimi është se ky lloj i biznesit duhet të shmanget në mënyrë që të mos nxiten bizneset ekzistuese të krijojnë zgjerim artificiale dhe gjithashtu të krijojnë shtrembërim të tregut.**

**4) Bizneset e prodhimitarisë së lehtë (prodhimtaria e ulët) janë më të favorshme për angazhimin e grave; këto biznese krijojnë mundësi të përhershme për rritje në të ardhmen. Ky është grup i bizneseve që janë relativisht të vogla në numër, por shumë e rekomanduar për mbështetje.** Megjithatë, kompetencat kryesore për sukses në këtë kategori të bizneseve janë të ndryshme nga grupet e tjera. Kompetencat me një rol vendimtar në suksesin e këtyre bizneseve janë:

- **Vizioni strategjik (ku do të jetë kompania në tre deri në pesë vjetët e ardhshme) të biznesit,**
- **Inovacioni (produkti (et) duhet të jenë në mënyrë minimale inovative për rajonin e Mitrovicës),**
- **Komunikimi (strategji e qartë e brendit, duke përfshirë komunikimin me blerësit dhe publikun),**
- **Zgjidhje analitike e problemeve dhe planifikimi për fazat e mëvonshme të zhvillimit, dhe**
- **Ndërgjegjësimi teknologjik.**

